



Dossier

## **ARNAUTI ISKENDER : Dokumente osmane që flasin për origjinën shqiptare të Skënderbeut**


3 Maj, 2018 1

*Autorët e këtyre veprave, megjithëse nga njëra anë vënë në dukje sulltanët dhe komandantët turq si figura që kanë luajtur rolin vendimtar në zhvillimin e ngjarjeve, nga ana tjetër duke shkruar në bazë të kujtimeve të veta ose të tregimeve të atyre që i kanë jetuar ngjarjet, zgjerojnë rrethin shoqërorë të pjesëmarrësve në këto ngjarje dhe japin njoftime shumë të sakta edhe për heroin kombëtar të shqiptarëve Skënderbeun, po edhe për masat popullore shqiptare*

**Nga Ilmi VELIU**

Veprat e kronistëve dhe historianëve të hershëm osmanë, ndonëse janë shkruar nga autorë që në shumicën e tyre ishin historiografë zyrtar e që mbanin një pozitë armiqësore ndaj shqiptarëve, jemi të detyruar të pranojmë se në shumë drejtime ata na japin të dhëna me një vlerë shumë të madhe sa i përket Skënderbeut, Kastriotëve dhe origjinës së tyre shqiptare, të cilat te dhëna nuk i hasim në burimet e autorëve tjerë jo


osmanë. Autorët e këtyre veprave, megjithëse nga njëra anë vënë në dukje sulltanët dhe komandantët turq si figura që kanë luajtur rolin vendimtar në zhvillimin e ngjarjeve, nga ana tjetër duke shkruar në bazë të kujtimeve të veta ose të tregimeve të atyre që i kanë jetuar ngjarjet, zgjerojnë rrethin shoqërorë të pjesëmarrësve në këto ngjarje dhe japin njoftime shumë të sakta edhe për heroin kombëtar të shqiptarëve Skënderbeun, po edhe për masat popullore shqiptare.



1) **ORUÇ BIN ADIL**. Është autor i njëres nga historitë më të vjetra të shtetit osman “Tevari el Osman”, (Historitë Osmane). Dorshkrimet e Oruçit, të gjetura në Oksford dhe në Kembrixh janë botuar nga Franc Babinger “Die Fruhosmanicshen Jaherbucher des Urudsch”, Hanover 1925. E para është një histori në formë të përmbledhur (Icmai tarihi), kurse e dyta është e hollësishme (Mufassal tarihi).

Uruç bin Adil kur shkruan për betejat e shumta kundër Skënderbeut, në faqe 96 të veprës së tij nuk e përmend Rumelinë, si që quhej pjesa evropiane e Perandorisë Osmane por potencon shumë kjarhtë se sulltani shkoi të luftonte kundër Iskenderit që kishte ngritur krye në tokat shqiptare, ose vendin e shqiptarëve (Arnavud ilinden) dhe jo në Greqi, Maqedoni ose në Serbi.


Në faqe 115, tokat shqiptare Oruç i përmend edhe si Vilajeti i Shqiptarëve (Arnavud Vilajetine). Ai thotë se “Ali Beu, i biri i Evrenoz Beut mblodhi ushtrinë dhe akinxhinjtë e Rumelisë dhe hyri në vilajetin e shqiptarëve, për të luftuar kundër Iskenderit...”. Në faqe 121 thotë se “Sulltan Murati II dërgoi akinxhinjtë kundër vilajetit të shqiptarëve për të pushtuar kështjellën e Sfetigradit. Sundimtari shqiptar Iskenderin nuk e gjetën...”. Në origjinal është “Arnavud begi Iskender” ku potencohet shumë qartë se Iskenderi ishte sundimtari i shqiptarëve dhe jo i serbëve, bullgarëve, grekëve, boshnjakëve, hungarezëve, popuj të cilët po ashtu ishin në luftë me sulltanin në kohën e Skënderbeut. Në faqe 123, Oruç potencon se “Sulltan Murati II zbriti në Vilajetin e Juvanit (Gjon Kastriotit), e plaçkiti Vilajetin shqiptarë, dhe sulmoi Krujën (Akçe Hisar), por nuk mundi ta pushtonte atë”. Nga kjo kuptojmë se përveç “Juvan Ili” (tokës së Gjonit ose vilajetit të Gjonit) ka pasur edhe principata tjera shqiptare e që përmenden si Vilajeti i Shqiptarëve (arnavud vilajeti).



2) **KRONIKAT ANONIME OSMANE.** Është fjala për veprën me titull “Tevarih El Osmaan” e cila përmbledh një numër të shumtë kronikash anonime të shkruara në fund të shek. 15 dhe fillimi i shek. 16. Këto kronika janë analizuar dhe botuar nga Franc Giese, me titull: “Die altosmanischen anonymen Chroniken”, 1922, Bruksell. Në faqe 65 të kësaj vepre përmendet principata e Gjon Kastriotit si tokë shqiptare ku thuhet se: “Sulltan Murati II... bëri një luftë të shenjtë dhe të madhe ku sulmoi tokat dhe kështjellat e Gjonit. (Endene Juvaan Ilerin ve kahlerin fetëhun Etedin).

Në vazhdim ne faqe 66 thuhet se Ali Beu, djali i Evrenoz Beut sulmoi dhe grabiti Vilajetin e shqiptarëve. Edhe kronikat anonime osmane, Skënderbeun e quajnë si “Sundimtar shqiptar”. Ja se çka thonë kronikat në faqe 70: “Sulltan Murat Hani kreu një fushatë kundër tokave të Juvanit (Gjonit) dhe vilajeteve tjera të shqiptarëve. Ai pushtoi kështjellën e Sfetigradit. Pushtoi pastaj edhe dy kështjella tjera. Sundimtari shqiptar-Iskenderi nuk u pa se ku ishte”. Kronikat kur flasin për sulmet e viteve 1450, 1466, 1467 dhe rrethimet e Krujës , janë shumë decide dhe të qarta se lufta është bërë kundër shqiptarëve të udhëhequr nga sundimtari i tyre shqiptar – Iskenderi.

Në faqe 125 thuhet se “shqiptarët në tokat e tyre kishin ngritur kulla në vendet e thepisura dhe në majat e maleve. Rrugët ishin aq të pakalueshme sa edhe sorrat nuk mund të fluturonin mbi to. Bile edhe djalli me shkop nuk do të mund të hynte në tokat e tyre”. Qëllimi im është që të hedh poshtë pohimet e disa historianëve sllavomaqedon, serbë e grekë, se Skënderbeu ishte me origjinë sllave. Autorët që unë i kam analizuar e potencojnë qartë origjinën e tij dhe se ai ishte komandant shqiptar dhe mbret i Shqipërisë.




ص. ۲۷۹ اقليم ارتودك ملوك قديمي  
نسلندن يوان اوغلي دمكله معروف شر  
و فسادله موصوف بر بد اصل و فاسد  
نهاد ظهور بولشدي آدي اسكندردي  
كندو مدت مديد سلطان مراد خانك

3) **ASHIK PASHA ZADE.** Është një nga kronistët e hershëm osman i cili jetoi gjatë shekullit 15. Veprën e tij e ka botuar Ali Beg , me titull “Ashik Pashazade tarihil Osman”, Istambull 1332 hixhri.

Për këtë kronist ka shkruar edhe Sami Frasheri në Kamusul al-lam, vl, IV. Në faqen 63 të veprës së tij Pasha Zade thotë se njeriu që e vrau Sulltan Muratin I – quhej Milush Kuble ose Bilush Kuble, e jo Milosh Obiliq si që e kanë emëruar serbet dhe nuk e cek përkatësinë kombëtare, por thotë se ishte një i pa fe nga tobori kundërshtar i osmanëve. Faqe 124-125, thotë se: “Isa Beu hyri në vendet e padepërtueshme të shqiptarëve dhe prej andej bënte sulme. Ndërkaq ata i ja bllokuan rrugët. Një arnaut i pa fe me emrin Iskender që ishte ‘i biri i sundimtarit shqiptar’, që kishte qenë ‘içogllan’ i sulltanit dhe tash kishte ngritur krye kundër tij, dhe ua kishte bllokuar rrugën akinxhijëve”.

Pra, Ashik Pasha Zade jo që e dokumenton në kronikën e tij se Iskenderi ishte shqiptar, por ai informon se ai ishte i biri i një sundimtari të shqiptarëve. A ka argumente më të forta historike se sa këto të dhëna që na jep Pasha Zade e që Petar Poposki dhe disa autorë tjerë serbë që shkruajnë për përkatësinë kombëtare të Skënderbeut, nuk i kanë lexuar ose nuk dëshirojnë ti lexojnë dhe të binden se ai ishte shqiptarë dhe bir shqiptari. Argumentet janë edhe më të forta kur kihet parasysh se këto fjalë i thotë një autor osman dhe nuk i thotë nga dashuria që ka pasur ndaj Skënderbeut por nga urrejtja.



4) **MEHMET NESHRI.** Ka qenë një poet shumë i njohur i kohës së Sulltan Selimit I. Vepra e tij e shkruar në vargje titullohet “Cihan Numaa”, (Treguesi i Botës), analizuar dhe botuar nga Franc Taechner, me titull “Die altosmanischen Hroniken des Mevlana Mehmet Neschri”, Lajpsig 1951. Në faqe 71 të veprës së tij, Mehmet Neshri tregon për pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës. Ai thotë se: “Llazarit i shkuan në ndihmë hungarezët, vllahët, çekët shqiptarët dhe bullgarët.

Faqe 79: ...ndër ta ishte një i pa fe me emrin Jorgji (Gjergji i II Ballsha) i cili kishte 90 mijë ushtarë. Kur Lazari tha që turqit të sulmoheshin natën ai tha: “O zotëri, më mirë ti sulmojmë në mëngjes dhe të gjithë ti kapim të gjallë”. Ushtria e Llazarit kishte pirë aq shumë raki sa që të gjithë ishin të dehur kur hynë në luftë. Shumica e dijetarëve mendojnë se këtu është fjala për Gjergjin e II Balsha, kurse Johan Von Hammer mendon se është fjala për gjyshin e Skënderbeut ose babain e Gjonit sipas të cilit, emrin e ka pasur “Gjergj Kastriori” dhe jo “Pal Kastrioti” si që e përmendin disa autorë, dhe se emri “Gjergj” që e ka pasur Skënderbeu ka qenë emri i gjyshit të tij. Në kapitullin e veprës së Neshriut “Lufta me shqiptarët” (gazaul arnevud) faqe 201 thuhet se Iskenderi, sundimtari shqiptar (Iskender arnavud begi oglu idi) e tradhtoi padishahun. Pastaj, truri i tij i brumosur me djallëzi e bëri atë që të jepej pas ngatërresave. Ai si hakmarrje, shkoi dhe grabiti shumë bagëti të osmanëve në malet e Tetovës (Kallkandelen). Kur sulltani iu drejtua vendit të shqiptarëve, Iskenderi u arratis nga Durrësi në drejtim të frengut (Italisë). Është fjala kur Skënderbeu shkoi në Itali për të kërkuar ndihmë dhe disa burime osmane atë e paraqesin si ikje të tij që të shpëtonte kokën. Më duhet të potencoi edhe njëherë thënien e Neshriut “Iskender arnavud begi” Skënderi, begu shqiptar.

ضی . ۷۰ . . . . . کتھ سلطان مراد سفر  
 اتمیب ادرندہ قرار اتدی سلطان  
 بایزید بن محمد خان وجودہ کلدی  
 ہجرتک ۸۵۱ یلندہ سلطان مراد خان  
 یوان التہ و ارنود ولایتلرینہ سفر  
 ایدب قچاجق حصارن فتح اتدی اکی  
 پارہ قلعہ داخی الدی یوان الن یغما

5) **DURSUN BEG.** Ka jetuar gjatë sundimit të Mehmetit II. Vepra e tij titullohet “Tarihi ebul Feth” (Historia e Babait të pushtimeve) e botuar nga Mehmet Arif, Istambull, 1914. Në faqe 123, ai thotë: “...Nga një anë tjetër popullsia mosmirënjohëse shqiptare u hodh vende-vende në kryengritje dhe guxoi të hynte në luftë, e udhëhequr nga kryeneçi Iskender. Pastaj vazhdon duke thënë se shqiptarët gjithmonë janë shkëlmuar prej potkonjve të kuajve të kalorësisë perandorake.

Faqe 132: “Mbasi sulltani u hakmuar kundër frengjëve dhe hungarezëve, u preokupua të zhdukte nga rrënjët shqiptarët mosmirënjohës të udhëhequr nga arnauti Iskender...” Por ata zunë shtigjet e maleve dhe të luginave të rrezikshme. Nga që ishin tepër të këqij, ata rezistuan me kokëfortësi dhe me tërbim të madh...”

Faqe 135: Ata që e kanë parë vendin e shqiptarëve e kanë ndjerë fortë ashpërsinë e ati vendi... Ndërsa për ata që nuk e kanë parë, mjafton që të dinë se në atë vend plotë rebelë, me shtigje të fshehta dhe gryka hyrjeje e daljeje të vështira për tu kaluar, nuk ka mundur të depërtojë si që thonë as Aleksandri i Madh.

Faqe 136: Arnauti, Iskender tradhtari i cili qysh si fëmijë ishte rritur në pallatin mbretëror, iku dhe pëlqeu rrugën e kryengritësit. Ai shkoi dhe u tha shqiptarëve, “unë jam djali i sundimtarit tuaj...”.

Pra ky është edhe një kundër-argument për ata që thonë se Skënderbeu ishte me origjinë sllave. Kjo që përmendëm është e shkruar nga penda e kundërshtarit të Skënderbeut, dhe ai nuk thotë serbi, bullgari, sllavomaqedoni, por thotë “Arnauti, Iskender tradhtari”. Dhe emri Arnaut përdorej nga turqit vetëm për shqiptarët, e që rrjedh nga emri arbër. Pra grekët nga Arbër- Arvanitis, serbët nga Arbër-Arbanas dhe osmanët nga Arbër-Arnavut.


وتالان ایدب ارنود بکی اسکندر قچورب  
 اول ولایت البوب کلیسالرن یقوب یرینہ  
 مسجد یاپ اهل اسلام اول ولایتده

6) **IDRIS BITLISI.** Në vitin 1501 emigroi nga Persia dhe u punësua në oborrin osman ku ndenji gjatë gjithë jetës. Vepra e tij titullohet “Hesht Bihisht” (Tetë parajsat) dhe

është e shkruar në Persisht. Për këtë autor kanë shkruar Hoxha Sadedini, në veprën e tij “Tacut tevarih”, Sami Frashëri, në veprën e tij ” Kamusul Al-lam dhe Katip Qelebi në “Keshfys-zunun”. Idris Bitlisi në filim përmed tokat e Karlit (Karli Ili) pra tokat e Karl Topisë. Pastaj kur permend sundimtarin e serbëve, Llazarin ai në faqe 188 të veprës së tij permend edhe sundimtarin e Shkodrës shqiptare, Jorgji (Gjergji i II Ballsha) i cili në një rast thotë se “Jorgji i kishte vrarë komandantit osman, Lala Shahinit 10-15 mijë ushtar.

Në vazhdim autori në mënyrë të drejtpërdrejt thotë se : “Shqiptari Iskender, i cili qe ngarkuar me detyra nga sultani, ishte një nga më të besuarit e më të shquarit, ndër personat e zgjedhur, që mbaheshin në shërbim të sulltanit. Do të thotë se ka qenë e njohur se Iskenderi ka qenë shqiptarë edhe në kohën kur ai ishte në oborrin e sulltanit, para se të kthehej në Krujë dhe qëndronte në krye të shqiptarëve. “...Kurse ata shqiptarët si shpendët grabitës, domosdo janë nga natyra trima e guximtarë sa s’ka se ku të vejë më”.

Faqe 127: Një nga shërbëtorët e sulltanit arnauti Iskender, që kish qenë rritur që fëmi me të mirat e Padishahut që kish gëzuar gjithmonë kujdesin, shpirtmadhësinë dhe ledhatimin e pakufizuar, i shtyrë nga lakmia që të bëhet mbret i Shqipërisë, bashkë me një grup intrigantësh u larguan nga selia e lumturisë. Si që shihet këtu autori na jep të dhëna direkte se vetë Iskenderi ka pretenduar se ka origjinën nga ajo tokë shqiptare dhe se ati i ka takuar që të kthehej atje dhe të bëhej mbret dhe udhëheqës i tyre.



ص. ۲۷۹ اقليم ارتودك ملوك قديمي  
نسلندن يوان اوغلي دمكله معروف شر  
و فسادله موصوف بر بد اصل و فاسد  
نهاد ظهور بولشدي آدى اسكندردي  
كندو مدت مديد سلطان مراد خانك

7) **KEMAL PASHA ZADE**. Ka qenë i biri një komandanti të njohur të sulltanit, Sulejman Celebi, i cili komandant ka marrë pjesë në pushtimin e Konstantinopolit. Edhe vepra e tij titullohet “Tevarih el Osman” (Historitë Osmane) Për këtë autor shkruan edhe Sami Frasheri në Kamusul Al-lam, vl.V.

Në faqe 279, autori thotë se: “Në vendin e shqiptarëve doli në skenë një njeri prej një fisi të vjetër mbretërorë, një ngatërrestarë dhe turbullues i njohur me emrin, i biri i Juvanit, emri i të cilit ishte Iskender.

Faqe 280: tradhtia e tij kriminale u bë e famshme kudo dhe të gjithë ne (Perandorinë Osmane) e thirrnim me emrin tradhtari arnaut Iskenderi. Ai shkoi dhe me lehtësi hyri në vilajetin e të atit të tij, i cili në vendin e shqiptarëve njihet me emrin nahija e ashpër e tokave të Juvanit. Populli i atij vendi e pranoi dhe iu nënshtrua, duke thënë së ky është djali i sundimtarit tonë. Në këtë mënyrë pushtoi vendin e sipërpërmendur dhe u bë mbret i shqiptarëve.

کوندروب سلطان محمد خانی کتورتدی  
اول غزاده بيله بولنمه سنی مناسب  
کوردی و الحاصل واردیلار ایکی آی  
تمام حرب و رزمه نیجه اغتنام حاصل  
قیلدر و حصارک صو حزینه سنی

- 8) **HOXHA SADEDINI.** Është një nga historianët më të dëgjuar osman, i cili ka marrë pjesë edhe në punët shtetërore. Vepra e tij titullohet “Tacut-tevarih” (Kurora e historive) dhe më së shumti përmendet si “Hoca Tevarihi”. Ajo që neve na lë përshtypje është shkrimi i tij për Skënderbeun në faqe 351, ku thotë se: “Sundimtari shqiptar kishte një djalë të pashëm që quhej Iskender, figura trupore e të cilit të frymëzonte dashurinë, ndërsa fytyra e tij tërheqëse ishte shprehëse e bukurisë dhe e hirësisë së tij. Ai e dërgoi Iskenderin në kryeqytet për të konfirmuar nënshkrimin e tij ndaj sulltanit. Është shumë interesant dhe rast shumë i rrallë që dikush nga autorët osmanë ta përshkruaj në këtë mënyrë pamjen fizike dhe bukurinë e Skënderbeut. Jo se ky autorë ka pasur ndonjë simpati por ai e ka thënë të vërtetën, pra ashtu si që është dukur Skënderbeu.

کوردی و الحاصل واردیلار ایکی آی  
تمام حرب و رزمه نیجه اغتنام حاصل  
قیلدر و حصارک صو حزینه سنی  
بولوب دوکمله کفاری صوسز قودلر  
بو طریقله خواه نا خواه کفاری زبون  
ایدوب قلعه یی فتح و تسخیر قیلدر

- 9) **ALI MUSTAFA BIN AHMED.** Ka shërbyer si sekretar i këshillit (Divan Katibi). Vepra e tij historike titullohet “Kunhul Ahbar” (Bërthama e lajmeve) Se Skënderbeu ishte me origjinë shqiptare, Ali e dokumenton në faqe 76 kur flet për Hamza Kastriotin dhe thotë se: Hamza beu ishte i nipi i Iskenderit të shqiptarëve.” Pra ai vërteton se Iskenderi ishte i shqiptarëve dhe jo i ndonjë kombi tjetër si që pretendojnë disa nga të ashtuquajtur historianë serbë ose sllavomaqedonë. Në vazhdim Ali tregon se: “Nga prijësit e vjetër kokëfortë e inatçi, me trupa divash, që ishin grumbulluar në disa kodra e vende të çuditshme, të pa depërtueshme....”

Në faqe 124 , Ali e përsërit edhe njëherë se Iskenderi ishte shqiptarë dhe thotë: “Një njeri i pa vlerë nga fisi shqiptar (arnaut) i quajtur me emrin tradhtari Iskender, i cili pasi u rrit dhe edukua në oborrin e sulltanit, doli jashtë dh mori rrugë të shtrembët..Ky djalë që ushqeui tradhtinë dhe intrigën ishte i biri i njërit prej banditëve të famshëm të asaj popullsie të keqe. Këtu e ka fjalën se ai ishte i biri i sundimtarit të më hershëm të shqiptarëve Gjon Kastriotit ku autorët osmanë e shënojnë si Juvan Kastrioti, ose principatën e Kastriotëve si “Juvan Ili” që do të thotë toka e Gjonit.

10) **SOLKZADE.** Është njëri nga historianët osmanë të shek. XVII. Vepra e tij titullohet si “Fihrist Shahan”, por sot më së shumti njihet si “Tarihi Sollakzade” (Historia e Sollkazades)



Ai në faqe 43 përmend pjesëmarrjen e shqiptarëve në Betejën e Kosovës, por në faqe 168 ai e përshkruan edhe pamjen fizike të Skenderbeut ku thotë se “...Pamja fizike e këtij njeriu të bukur të çlodhë sytë, kurse fytyra e tij tërheqëse të jepte një kënaqësi të madhe. Pastaj më poshtë vazhdon ndryshe: “Ai sojëkeq dhe fatëzi i harroi mirësitë e padishahut dhe i kthehu shpinën atij. Kur ky lajm u muar vesht nga mbreti, ai dërgoi ushtri kundër tij dhe vendit të shqiptarëve, nën komandën e Isa Beut. Kryengritësi i lartpërmendur nuk u kap dot dhe një kohë të gjatë u fsheh nëpër male të egra të Shqipërisë”.

11) **MYNEXHIMBASH.** Është historian i shek. XVII. Vepra e tij titullohet “Sahaful ahbar”, e botuar nga Nedim Ahmet, me titull “Mynexhimbashi Sahaful ahbar”, Istambull 1285 h.

Në faqen 352 autori i përsërit të dhënat që i përmendëm edhe tek autorët tjerë më lartë. Me siguri se ai gjatë shkrimit të historisë së ti është mbështet tek këta autorë. Ai përsërit se Iskenderi ishte i biri i Juvait, sundimtarit shqiptar dhe se ishte rritur në oborrin e sulltanit. Kishte qenë i emëruar nga sulltani si zëvendës i të atit në tokat shqiptare. Pastaj e tradhtoi sulltanin dhe iku në Shqipëri dhe ngriti krye kundër sulltanit.

Pra autorët sllavë që kanë shkruar bashkë me disa gazetarë shqipfolës, që edhe sot shkruajnë se Skenderbeu ishte me origjinë sllave duhet ta kuptojnë se ai i hoqi nga krahu të gjitha gradat osmane dhe iku e shkoi në Shqipëri, ose shkoi dhe u ba mbret i Shqipërisë dhe i shqiptarëve e nuk thonë se iku dhe shkoi në Serbi Greqi ose Bullgari që të bëhet mbret i tyre. Pra është e natyrshme që secili kthehet për të luftuar dhe për të dalur zot tokës që e ka lindur dhe as-sesi në tokë të huaj. Vetë autorët osmanë e



vërtetojnë se ai ishte nga gjaku i shqiptarëve dhe ishte i gatshëm ta derdhte atë gjak për tokën shqiptare. (koha.mk)

Burimi: <http://www.koha.mk/arnauti-iskender-dokumente-osmane-ge-flasin-per-origjinen-shqiptare-te-skenderbeut/>